

Diaspora

Zvicër: Tel. +41 (0) 79 705 19 00 · E-Mail: diaspora@zerionline.info
Gjermani: Tel. +49 (0) 7331 30 18 19 · Fax: +49 (0) 7331 30 18 96 · E-mail: diaspora@zeridites.de

Di@-logu Sërish për imazhin tonë

Duket se aktiviteti kryesor i subjekteve tona për së paku edhe dy-tre muajt e mbetur deri në pushimet verore do të mbetet gara kush po e feston më mirë pavarësinë e Kosovës. Në këto rrethana, ne si redaksi e diasporës vazhdojmë me përpjekjen për krijim të opinionit që orientojnë drejt punëve më me përparësi dhe më të ngutshme që e presin një komunitet, në rastin tonë, diasporën shqiptare në Evropë. Prandaj, tema e radhës për dialogun tonë është: "Sërish për imazhin e shqiptarëve të Kosovës jashtë vendit". Adresa jonë: diaspora@zerionline.info

www.zeridites.de

Performansë interesante artistike zvicerane-shqiptare në Cyrih

"Tash edhe unë kam shtet, identitet" në mes të Cyrihut!

Një kamion me një ngarkesë të çuditshme i ka përshkuar rrugët e Cyrihut për tre ditë me radhë. Skulptura "Newborn" me ngjyrë të verdhë, plotësisht identike me simotren e saj në Prishtinë, me këngët rep në gjuhën shqipe në sfond, ka nxitur reaksione nga më të ndryshmet teksa "kalëronte" në shpinë të kamionit të zbuluar në qytetin e Cyrihut...

Blerim Shabani

Dita e 7 qershorit 2008 nga të gjithë qytetarët e Cyrihut dhe të Zvicrës identifikohet si dita e fillimit të Kampionatit Evropian të Futbollit. Me këtë ditë në këtë qytet pastaj lidhen qindra ngjarje mediale, të mëdha e të vogla të komercializuara deri në skajshmëri, të cilat, të gjitha, të orientojnë drejt një destinacioni të vetëm, drejt kampionatit pra. Vetëm një aktivitet i zhvilluar nga 5 deri më 7 qershor 2008 nuk hynte në këtë itinerar. Ishte madje të thuash e kundërta e kësaj... Një grup artistësh, profesorë dhe studentë, kishin lansuar një projekt interesant dhe krenar të veçantë. Ata kishin vendosur që përmes një performancë të bënin protestën e tyre artistike duke vendosur në një kamion skulpturën e përbërë prej shkronjash që formojnë fjalën "Newborn" (I porsalinduri), kopje e asaj të përruar në Prishtinë më 17 shkurt, në ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kamioni i cili do të shoqërohej nga një ekip me kamera do të shëtiste nëpër rrugët e Cyrihut dhe do të ndalonte në disa sheshe të këtij qyteti, ku këngëtari shqiptar i repit Arlind Pajaziti do të këndonte në gjuhën shqipe dhe frënge dhe shqipe. Kënga e vetme, e cila edhe gjatë rrugëtimit të kamionit do të dëgjohej tërë kohën nga altoparlanti, bën fjalë për Kosovën, për identitetin e saj të ri, për krenarinë e shqiptarëve që janë bërë me shtet etj. "Tash edhe unë kam shtet, kam identitet, kam..." është vetëm një fjalë më identifikuese nga refreni i këngës që jehonte rrugëve të Cyrihut nga 5 deri 7 qershor, sa zgjati ky projekt interesant artistik. Por çfarë kanë të bëjnë Kosova, identiteti i saj i ri dhe shqiptarët, me një performancë të tillë artistike dhe me Cyrihun? Njëri nga ini-



Arlind Pajaziti këndon shqip për shtetin dhe identitetin e Kosovës, në një shesh të Cyrihut

ciatorët, teoricienit i medieve Felix Stalder na e jep këtë shpjegim: "Projekti ynë që po e ndiqni merret me atë se si të mundësohet konstituimi në hapësirën publike të Cyrihut i shumë grupeve dhe forcave të ndryshme.

Felix Stalder: Shqiptarët po e fitojnë gradualisht vëmendjen dhe vetëbesimin...


Nga njëra anë kemi këtu parasysh grupe nga të emigracionit, më saktë migracionin shqiptar, i cili në Cyrih për një kohë të gjatë ka qenë pothuaj i padukshëm, natyrisht, po u përjashtuan rrefimet nga kronikat e zeza. Ndërkaq vetë shqiptarët, njerëzit dhe kultura e tyre ishte të thuash e padukshme. Me themelimin e shtetit të tyre nacional shqiptarët e Kosovës

po fillojnë të bëhen më të dukshëm dhe të fitojnë një prezantim tjetër, më me vetëbesim". Ndërsa rreth mënyrave të mundshme të perceptimit të performancës së tyre nga kalimtarët, z. Stalder shprehet: "të mësuar me maninë e reklamave, shumica e njerëzve që kalojnë para skulpturës sonë mund ta perceptojnë atë si edhe një reklamë të radhës. Qëllimi ynë është që punimi ynë të lexohet dhe përjetohet në mënyra të ndryshme nga njerëz të ndryshëm që vijnë nga kontekste të ndryshme. Ne e bëjmë këtë aksion pikërisht në hapësirë publike për të parë reaksionet dhe për të mbledhur material për bërjen e një filmi dokumentar ku do të kombinohen rrafshet e ndryshme të kuptimit të tij. Sigurisht, janë vetëm shqiptarët dhe njerëzit nga Ballkani që e kuptojnë tamam se për çka bëhet fjalë në këtë projekt. Kështu, një shofer shqiptar taksie kur e pa skulpturën, i entuziazmuar dhe befasuar na pyeti: Ç'bën kjo skulpturë këtu? Tamam sikur në Prishtinë...". Ndërsa lidhur me angazhimin në këtë projekt të reperit nga grupi Eki Nox, Arlind Pajaziti, z. Stalder thotë: "E kemi zgjedhur pikërisht Arlindin sepse ai i njeh të dy realitetet, si atë të Kosovës prej nga vjen ashtu edhe realitetin e Zvicrës, ku ai jeton aktualisht dhe për këtë arsye ai mund të bëjë një lidhje të mirë në mes tyre". Performanca që po realizojmë, vazhdon Stalder, është në një mënyrë aksion ilegal, por duke qenë se nuk pengon askënd dhe fundja është diçka e bukur për tu parë, policia nuk na ka penguar. Ne në fakt jemi deri diku edhe të

interesuar për "fërkime" por jo për konflikt e as për refuzim, pra, thënë qartë, ajo që duam në është njëfarë provokimi artistik i opinionit", përfundon Felix Stalder.

- Arlind Pajaziti, shteti i ri, identiteti dhe krenaria se është rritur në dy kultura

I riu nga Peja me qëndrim në Estvayer të Zvicrës frankofone, Arlind Pajaziti, është anëtar i grupit Eki nox. Ai gjatë tri ditëve sa



Skulptura "Newborn" në drejtim të zonës së rezervuar për tifozët e kampionatit Evropian të futbollit

ka zgjatur aksioni artistik "Newborn undeliverable" ka fituar një përvojë shumë interesante dhe me vlerë. "Jam pjesëmarrës i kësaj iniciative artistike të realizuar nga Christian Kubler dhe Felix Stalder, profesorë të akademisë së arteve në Cyrih. Është ky një aktivitet për sensibilizimin e hapësirës zvicerane me praninë e shqiptarëve dhe të huajve tjerë në Cyrih. "Newborn" është, një kopje e skulp-

tures së zbuluar më 17 shkurt ditën e pavarësisë në Prishtinë dhe si e tillë sigurisht lë përshtypje. Nga kjo shëtitje që po bëjmë rrugëve të qytetit ne jemi duke e punuar një videoprojekt. Siç e shihni pra, gjatë tërë kohës jemi të përcjellë nga dy kamera rrugëve të Cyrihut". Lidhur me reagimet e qytetarëve të Cyrihut, Arlindi thotë "Ata që e kanë të njohur këtë motiv, kryesisht shqiptarët, e perceptojnë shumë mirë këtë pamje që e kanë parë në media me rastin e shpalljes së pavarësisë dhe muzikën, tekstin e saj në gjuhën shqipe. Por ka edhe të tillë, jo shqiptarë, sigurisht, që e kundërshtojnë. Kështu, fjala vjen dje, e kemi pasur një provokim të vogël, kur një grup grekësh nga një veturë na thërrisnin: "go away!"

Arlindi ka jetuar edhe në Kosovë ndërsa në Zvicër, ku i ka mërguar prej vitesh babai, ai jeton një kohë të gjatë prandaj edhe ndjehet si "secondo" (pjesëtar i brezit të dytë të huajve). "Unë në këtë projekt flas si shqiptar i brezit të dytë të mërgimtarëve. Babai im ishte emigrant në Zvicër. Unë prandaj këtu e pasqyroj atë gjendjen e njohur ku jemi ne tash, 'as andej - as këndej'. Në Kosovë më quajnë "ky i jashtit" këtu po ashtu na quajnë të jashtëm, persona klandestinë..." Por Arlindi nuk e ka ndërmend të bjerë në depresion për këtë. Përkundrazi. "Unë në tekstin e këngës them po ashtu se jam me fat që i kam dy kultura dhe e ndjej veten krenar për këtë. Bëj fjalë edhe për politikë, për atë çfarë ka vuajtur Kosova dhe për



Kalimtarët komentojnë lidhur me performancën

krenarinë që kemi me shtetin tonë të ri, të porsalindur... Grupi ynë, Eki Nox është i njohur për angazhimin e tij shoqëror dhe mendimi im është thjesht se repi nuk është rep po nuk që i angazhuar", thotë në fund Arlind Pajaziti duke uruar që performanca "Newborn undeliverable" të zgjojë sa më shumë kureshtjen e qytetarëve të Cyrihut, sigurisht, edhe të shqiptarëve në mesin e tyre.